

**Njoftim për përqendrim me të cilin VALTEK SE Luksemburg do të fitojë kontroll mbi  
VALTEK MOBILITI GMBH Gjermani  
(lënda nr. 08-66/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 21.03.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë njoftim për përqendrim që i referohet blerjes së të gjitha aksioneve nga VALTEK SE 18, rue Erasme, L-1468 Luksemburg në Valtek Mobiliti GMBH Mars-strasse 46, 80335 Muni, Gjermani.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

Valtek ofron një gamë të gjerë shërbimesh në sektorin e IT-së, duke përfshirë rrjetëzimin digjital të shërbimeve dhe produkteve, planifikimin teknik dhe kontrollin e kanaleve të shitjes, e-tregtinë, analizën e të dhënave dhe mbledhjen e të dhënave, menaxhimin e të dhënave, platformat e të dhënave dhe transmetimin video. Valtek punon për klientë në sektorë të ndryshëm industrialë, duke përfshirë udhëtimin, mikpritjen, automobilistikën, mediat, shitjen me pakicë, kujdesin shëndetësor dhe financat.

Valtek është një shoqëri portofoli e fondit të investimeve BC Partners Fund XI. BC Partners Management XI Limited ("Menaxheri") është menaxheri kryesor i BC Partners Fund XI dhe në fund këshillohet nga BC Partners LLP ("BC Partners"), një shoqëri ndërkombëtare me kapital privat e themeluar në Londër, aktiviteti i vetëm i së cilës është të ofrojë shërbime këshilluese. BC Partners Fund XI së bashku me fonde të tjera private të kapitalit të këshilluara nga BC Partners (së bashku "Fondet e BC") kanë pjesëmarrje shumicë në shoqëritë portofoli në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, shërbimet industriale dhe teknologjinë. Fondet e BC janë investitorë thjesht financiarë, pra nuk janë të përfshirë në operacionet e përditshme të shoqërive të tyre portofoli. Në vend të kësaj, ato menaxhohen nga ekipe menaxheriale të pavarura.

Valtek ka dy shoqëri të lidhura në Maqedoninë e Veriut:

- Valtek SHPKNJP Shkup, me seli në adresën Stoltenbergova 4, Lamela A-majtas, Qendër Shkup, me veprimtari të regjistruar 62.100 - programim kompjuterik; dhe
- Kin and Carta Maqedonia SHPKNJP Shkup, me seli në adresën Stoltenbergova nr. 4, Shkup, me veprimtari të regjistruar 62.01 - programim kompjuterik.

Më tej, United Group, e cila është një shoqëri portofoli e BC, ka tre shoqëri të lidhura në Maqedoninë e Veriut:

- Total TV SHPK Shkup, me seli në adresën bul. Partizanski Odredi 17, 1/001, Shkup, Qendër me veprimtari të regjistruar 61.30 - Aktivitete të telekomunikacionit satelitor;
- UGI FIBER SHPKNJP Shkup me seli në adresën bul. Partizanski Odredi nr. 14, Shkup - Shkup, Qendër me veprimtari të regjistruar 61.100 - Aktivitete telekomunikacioni me kablo, pa kablo dhe satelitore; dhe

- DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup me seli në adresën rr. Kosta Veselinov, 5/11ok2, Qendër, Shkup me veprimtari të regjistruar 73.110 - Aktivitete të agjencive reklamuese.

Valtek Mobiliti aktualisht është një sipërmarrje e përbashkët midis Valtech Germany GmbH, një shoqëri e lidhur në pronësi të plotë të Valtek, dhe CARIAD SE, pjesë e Grupit Volkswagen ("CARIAD"). Valtek Mobiliti është një shoqëri e shërbimeve IT që zhvillon softuer veçanërisht për aplikim në industrinë automobilistike. Ajo gjeneron pothuajse të gjithë shitjet e saj (afërsisht 96% në vitin 2023) me shoqëritë që i përkasin Grupit Volkswagen, të cilit i përket edhe CARIAD.

Valtek Mobiliti nuk është aktive në Maqedoninë e Veriut, as nuk ka shoqëri të lidhura, degë ose përfaqësi në Maqedoninë e Veriut.

Sipas parashtruesve të njoftimit, si tregje relevante për përqendrimin në fjalë mund të përcaktohen: tregu i shërbimeve IT në Maqedoninë e Veriut.

*Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.*

27.03.2025

Shkup